



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 01.10.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 4, 11 dhe 16 shtator 2019.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik””.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban””.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban””.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Krenar Ryçi, Evis Kushi, Arben Elezi, Korab Lita, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Anastas Angjeli dhe Ervin Bushati.

Të ftuar:

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëdita!

Le të futen mediet nëse janë të pranishme.

Vazhdojmë me rendin e ditës së sotme, pasi edhe ju më keni kërkuar të ecim me shumë dilixhencë.

Sot në rendin e ditës kemi katër pika. Si pikë të parë kemi miratimin e procesverbaleve të datave 4, 11 dhe 16 shtator.

Ju uroj një muaj të mbarë të gjithëve!

Si pikë të dytë kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale Gjermane për bashkëpunim teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Europian në sektorin ekonomik””.

Si pikë të tretë kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin e shtratit të lumit Lana, zhvillimi urban” dhe si pikë të katërt të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin e shtratit të lumit Lana, zhvillimi urban”.

Si përfaqësuese e Ministrisë së Financave është zonja Belinda Ikonimi, zëvendësministre. Deri sa është e pranishme Belinda, nuk është e nevojshme të jetë ndonjë tjetër.

Sa u takon miratimin të procesverbaleve i keni pasur në *e-mail*. A ka ndonjë prej jush ndonjë koment për procesverbalet para se t’i kalojmë për aprovim? Jo.

Faleminderit!

Miratoohen procesverbalet.

Kalojmë në pikën e dytë. Fjalën e ka zonja Reme Lala si relatore e projektligjit.

Reme Lala – Faleminderit!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale Gjermane për bashkëpunim teknik 2018 për

projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin European në sektorin ekonomik” është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32 dhe 39 të Rregullores së Kuvendit.

Marrëveshja është hartuar në vazhden e bashkëpunimit të suksesshëm të vendit tonë me Gjermaninë. Prej më shumë se 30 vjetësh Gjermania ka qenë donatori më i madh i vendit tonë dhe ka financuar qindra projekte në sektorët kyç të ekonomisë, siç janë energjia, transporti, furnizimi me ujë e kanalizimet, turizmi, arsimi, bujqësia e të tjera. Totali i financimeve të saj është mbi 1 miliard euro, duke dhënë një kontribut të fuqishëm në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit tonë.

Kontributi nga ana e Gjermanisë ka qenë jo vetëm ekonomik e financiar, por edhe teknik, me qëllim avancimin e reformave dhe mbështetjen e vendit tonë drejt integritit në Bashkimin European. Është për t’u theksuar fakti se jo më larg se 5 ditë më parë parlamenti gjerman votoi me 395 vota pro fillimit të bisedimeve për anëtarësim. Marrëveshja që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj parashikon financimin me grante nga qeveria gjermane me vlerë të përgjithshme prej 2 milionë eurosh, për projektin mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik. Ky grant do të përdoret për financimin e shërbimeve të personelit dhe të materialeve të nevojshme për realizimin e projektit. Projekti ka një kohëzgjatje për 3 vjetësh. Kjo marrëveshje është hartuar në zbatim të marrëveshjes bazë për bashkëpunim teknik me qeverinë gjermane të vitit 1988. Ajo mbështetet në protokollin e bisedimeve me qeverinë gjermane, nëntor 2018, si dhe forcon dhe synon thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit teknik me qeverinë gjermane për të kontribuar në zhvillimin ekonomik e social të vendit tonë. Objekti kryesor i saj është forcimi i kompetencave të institucioneve shqiptare për zhvillimin e bisedimeve, për anëtarësim në Bashkimin European, me fokus legjislacionin ekonomik.

Projekti pritet të sjellë përmirësime në tri fusha kryesore, siç janë: zhvillimi i kapaciteteve dhe i metodologjive të grupeve ndërinstitutionale të punës, duke i pajisur me njohuritë e nevojshme për zhvillimin e negociatave; mbështetja për përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, si dhe përfshirja e shoqërisë civile në përgatitjet për bisedimet e anëtarësimit.

Gjithashtu, duhet theksuar se marrëveshja parashikon disa lehtësi për palën financuese si përjashtimin e të gjitha mallrave, automjeteve, pajisjeve nga detyrimet tarifore; përjashtimin e agjencisë zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, si dhe rimbursimin e vlerës

së TVSH-së apo të taksave të ngjashme indirekte. Marrëveshja ka rëndësi të veçantë, pasi nëpërmjet një financimi në formë granti sigurohet mbështetja e institucioneve shqiptare për zhvillimin e negociatave me strukturat e BE-së. Ajo do të kontribuojë në thellimin e bashkëpunimit të vendit tonë me Gjermaninë, si dhe do të çojë përpara procesin e anëtarësimit të vendit tonë në BE.

Për këto arsye i propozoj komisionit miratimin e projektligjit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Lala!

Zonja zëvendësministre, a dëshironi të shtoni ndonjë gjë përtej asaj që relatoi zonja Lala? Nëse nuk keni ndonjë gjë të re...

Fjalën e ka zonja Belinda Ikonomi.

Belinda Ikonomi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zonja parafolëse sapo na referoi të gjithë rëndësinë e këtij projektakti, i cili do të miratohet sot prej jush. Procesi i integritetit të Shqipërisë pa dyshim është një nga prioritetet kyçe të qeverisë shqiptare dhe tashmë ky proces prej mëse 1 viti ka hyrë në një fazë të re, në procesin e *pre screening*. Do të doja të nënvizoja faktin që procesi i negociatave të anëtarësimit është një proces sa politik aq edhe teknik dhe suksesi varet nga niveli i përgatitjes së administratës shqiptare. Duke qenë se Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka peshën më të madhe si lideri i 13 kapitujve të *acquis* është e nevojshme pa dyshim që të kenë mbështetje.

Aktualisht, kjo është faza e dytë, sepse ne kemi pasur mbështetjen e qeverisë gjermane dhe të GIZ-it gjatë viteve 2015-2018, ku mbështetja ka qenë pikërisht në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore dhe tashmë po kalojmë në një nivel më të avancuar, pikërisht në fuqizimin e kapaciteteve administrative. Sikundër u përmendën edhe nga deputetja, është pikërisht futja e koncepteve të reja, si përfshirja e shoqërisë civile, kushtet, parakushtet, trajnimi i stafit për të negociuar, elemente këto mjaft të rëndësishëm në këtë fazë të rëndësishme të procesit.

Ne kërkojmë mbështetjen tuaj për ta miratuar këtë projekt, sepse me të vërtetë administrata shqiptare ka nevojë për këto trajnime dhe mbështetje.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ikonomi!

A ka ndonjë pyetje.

Krenar Ryçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua t'i bëj një pyetje zëvendësministres në lidhje me këtë fond. A keni ndonjë plan konkret se ku do të përdoret ky fond dhe si do të menaxhohet nga ana juaj si ministri? A keni rakorduar ju si ministri se ku është më e domosdoshme që të përdoret ky fond?

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ikonomi.

Belinda Ikonomi – Faleminderit!

Pa dyshim, për çdo kapitull janë ngritur grupe ndërinstitutionale, të cilat kanë një plan veprimi të qartë lidhur me çfarë masash duhet të marrë çdo institucion i përfshirë, pasi një kapitull përfshin shumë institucione. Ne jemi në fazën ku kemi bërë një vlerësim të të gjitha mangësive ligjore, pra të të gjitha akteve, të cilat duhen riparë nga ana e administratës për të qenë në përputhje të plotë me *acquis* të BE-së, si dhe kemi një plan të përcaktuar për kapitujt kryesorë ku ne shohim se kemi problematika dhe kërkohet një angazhim dhe një trajnim më i mirë i stafit. Këtu pa dyshim GIZ-i, si dhe mbështetja nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila mbikëqyr të gjithë procesin, pikërisht për të siguruar që mbështetja financiare është atje ku duhet për të përmbushur qëllimin dhe që të gjitha strukturat të jenë gati.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Kush e do fjalën?

Po, zonja Topi.

Suzana Topi – Përshëndetje!

Pa dyshim që ky projektligj është shumë i rëndësishëm edhe për vetë faktin që jemi në prag të negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Në nenin 1 të draftmarrëveshjes është përcaktuar që qeveria e Republikës Federale Gjermane vë në dispozicion grantin prej 2 milionë eurosh. Po në nenin 1 përcaktohet se Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor për zbatimin e këtij projekti. Pyetja është: sa do të jetë ky planifikim në buxhet? A është parashikuar se ku do të përdoren këto shpenzime?

Arben Ahmetaj – I përgjigjem unë Suzanës.

Brenda buxhetit ka një kategori në bazë të planifikimit buxhetor dhe të asimilimit të fondeve, që quhet kosto lokale dhe TVSH. Nëse e dëgjuat zëvendësministren, ajo iu referua TVSH-së dhe taksave indirekte të ngjashme, e cila do të thotë se do të përjashtohen apo rimbursohen. Në normalitet, kjo varet nga marrëveshjet për çdo vend, përjashtohen ose rimbursohen. Në fakt, Gjermania e ka përjashtim, sepse ka marrëveshjen e vet bazë të vitit 1993. Kur bëhet planifikim buxhetor kjo nuk diskutohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Suzana Topi – Pra, janë taksat që do të...

Arben Ahmetaj - Nëse ka taksa indirekte për teknologjinë, që mund t'i duhet, për pajisje apo gjëra të tjera që mund të shfaqen gjatë aktivitetit të donatorit në Shqipëri, sepse siç u referua vetë zëvendësministria ka dy lloj përgatitjesh. E para, është përgatitja për kapitujt me negociatorët e negociatave dhe e dyta është harmonizim. Sigurisht që gjatë aktiviteteve ekonomike të mundshme mund të planifikohen edhe aktivitete që kanë konsekuenca ose transaksione të taksave indirekte, siç është TVSH-ja ose...

Suzana Topi – Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Më fal, zonja Suzana! Pyetjes suaj iu përgjigja unë, meqë zëvendësministria është marrë me pjesën e zhvillimit ekonomik së bashku me drejtoreshën Hafizi, e cila erdhi në kohë, madje edhe para zëvendësministres dhe po na priste të gjithëve këtu.

A ka pyetje të tjera? Jo.

Ndonjë opinion?

Kam unë një opinion.

Në radhë të parë falënderoj zonjën Belinda!

Është e rëndësishme të theksojmë se Shqipëria po pret hapjen e negociatave në datën 18 tetor dhe kjo patjetër që është një ngjarje shumë e madhe për qytetarët shqiptarë, pavarësisht politizimit që mundohen t'i japin palët politike. Kryeministri e ka theksuar se hapja e negociatave është për vendin, nuk ka të bëjë thjesht me qeverinë e Republikës së Shqipërisë as me opozitën, por me qytetarët e saj.

Ajo që unë dua të theksoj është fakti se hapja e negociatave është një mundësi modernizimi për vendin dhe sfida më e madhe është zbatueshmëria teknike që rrjedh nga negociatat. Në vetvete negociatat janë të vështira, teknikisht të komplikuar diku-diku, por sigurisht që sfida e administratës është që të jetë gati. Në të gjitha analizat që kemi bërë qoftë kur kemi qenë në kabinet, qoftë tani që jemi në komisione, theksoj se administrata ka nevojë për më shumë përgatitje, këtu po i referohem pjesë së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në mos gaboj, janë gati 17 kapituj direkt dhe 14 indirekt. Kjo do të thotë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të jetë shumë e përgatitur dhe në avancë në krahasim edhe me ministritë e tjera, sepse ka kapituj shumë të rëndësishëm të sferës ekonomike dhe jo vetëm. Jam i bindur që ky grant, megjithëse duket si modest është shumë i rëndësishëm, nuk është aspak modest, përkundrazi është kontribuues,

mjafton që të shfrytëzohet nga administratave dhe qeveria shqiptare për përmirësimin e përgatitjes për hapjen e negociatave.

Faleminderit, zonja zëvendësministre dhe zonja drejtoreshë që erdhët në kohë! Nëse vini gjithmonë kështu jeni të mirëpritur gjithmonë në komision.

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë të bëhet gati raporti me firmë.

(Diskutime pa mikrofon)

Hedhim në votim në parim projektligjin. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2 “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë projektligjin në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Të bëhet gati për seancë në bazë të Rregullores së re.

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.10.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban””.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Krenar Ryci, Evis Kushi, Arben Elezi, Korab Lita, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Anastas Angjeli dhe Ervin Bushati.

Të ftuar:

Belinda Ikonimi – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi - Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj - Përfaqësues i Drejtorisë së Borxhit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arbër Mazniku – përfaqësues i Bashkisë së Tiranës

Arben Ahmetaj - Vazhdojmë me pikën e dytë, shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin e shtratit të lumit Lana, zhvillimi urban”. Relatore e këtij projektligji është zonja Evis Kushi.

Zonja Kushi, fjala për ju.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Projektligji që do të diskutojmë synon ratifikimin e marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin e rehabilitimit të shtratit të lumit Lana dhe zhvillimin urban. Bëhet fjalë për një kredi prej 8 milionë eurosh për të financuar këtë projekt, me një kohë maturimi prej 20 vjetësh, 4 vitet e para pa pagesë principali dhe me interes, i cili do të përcaktohet në momentin e disbursimit. Është një projekt, i cili synon të zgjatojë dy bulevarde, bulevardet “Gjergj Fishta” dhe “Bajram Curri”, si dhe të rehabilitojë shtratin e lumit Lana përgjatë këtij segmenti. Është një sipërfaqe prej 110 hektarësh që do të përfitojë nga ky projekt dhe parashikohet drenazhimi, kanalizimi, ndriçimi publik, korsia e biçikletave, e autobusëve e të tjera, si dhe standarde punimesh që lidhen me regjimin hidraulik eficient, që nënkupton se do të shmanget e gjithë problematika e përmytjeve, e cila ka qenë shumë e theksuar për këtë zonë.

Me pak fjalë projekti jo vetëm që do të garantojë një infrastrukturë të përmirësuar dhe të qëndrueshme në këtë zonë, por do të mundësojë edhe hapësira për zhvillimin urban, ekonomik e social në të gjitha këto zona që preken dhe influencohen, por edhe në zonat përreth.

Sa i takon projektit, në total vlera është 23,7 milionë euro, nga të cilat 8 milionë është kredia që po diskutojmë, por përveç kësaj ka edhe një grant prej 2,4 milionë eurosh dhe pjesa që mbetet diku te 13,3 milionë euro do të financohet nga fondet e Bashkisë së Tiranës. Për zbatimin e këtij projekti do të ngarkohen ë Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Nuk po zgjatëm me detajet teknike, por nëse komisioni do të ketë interes, natyrisht janë të pranishëm përfaqësuesit e ministrisë. Projekti do të zbatohet përgjatë 3 vjetëve buxhetore nga 2019...

Arben Ahmetaj – Më falni, fillojmë nga fillimi meqë erdhi zoti Roshi, apo jo?

Evis Kushi – Në aspektin ligjor ky projektligj ka ardhur në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ndërsa në aspektin procedural është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Për të gjitha këto arsye i ftoj kolegët që ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Kush janë këta djemtë?

Belinda Ikonomi – Ju kërkojmë ndjesë zoti kryetar, por ishin te Komisioni i Veprimtarive Prodhuese. Zotërinjtë janë zoti Bushaj, përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë...

Arben Ahmetaj – Si quheni?

Belinda Ikonomi – Tedi Bushaj.

Arben Ahmetaj – Në çfarë departamenti punoni?

Tedi Bushaj – Në Drejtorinë e Borxhit.

Belinda Ikonomi – Gjithashtu i pranishëm është zoti Enrik, drejtor i Projekteve që vjen nga Bashkia e Tiranës.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Nuk është e nevojshme prania e djemve dhe arsyeja është se komisioni ynë është primar sa i takon kësaj marrëveshjeje, prandaj duhet ta kishit filluar nga këtu.

Faleminderit, Tedi!

Ju lutem largohuni!

Herë tjetër kur duhet të jeni të pranishëm në komisione duhet ta filloni nga Komisioni i Ekonomisë Tedi, dakord? Ti më shumë se kushdo e di shumë mirë këtë gjë se vajte një jetë që merresh me borxhin.

Tani dilni përjashta.

Zonja zëvendësministre, kishit ndonjë gjë për të shtuar? Jo.

Faleminderit!

A ka ndonjëri prej jush pyetje?

Fjalën e ka zonja Topi.

Suzana Topi – Pa dyshim projekti i shtratit të lumit Lana është një projekt shumë i rëndësishëm për zhvillimin urban të zonës, për disiplinimin e ujërave të zeza dhe të bardha, për infrastrukturën rrugore. Pyetja që unë kam është: Sa do të jetë norma e interesit të kredisë së marrë prej 8 milionë lekësh?

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, nuk është e shkruar. Në të është shkruar që do të bëhet sipas rregullit në momentin e disbursimit.

Pra, nëse ky projekt do të zbatohet, atëherë duhet të prishen disa banesa dhe ne nuk dimë nëse banorët e tyre do të kompensohen apo do të shkojnë në banesa sociale. Cili do të jetë impakti i tyre?

Pyetja tjetër. Ne kemi përpara një projektligj, por nuk kemi një projekt, çfarë do të bëhet?

Arben Ahmetaj - Zonja zëvendësministre, për hatër të Suzanës, do t'ju jap unë një përgjigje. Në përgjithësi, marrëveshjet financiare nuk shoqërohen me projekte, pra nuk është projekti këtu, por marrëveshja financiare. Pra, nuk është ende një kontratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Suzana, mos ngulni këmbë, nuk është kontratë, është marrëveshje financiare, e cila i garanton Republikës së Shqipërisë të drejtën e grantit. Projekti nuk vjen në Kuvend. I takon Bashkisë së Tiranës që të jetë agjenti zbatues. Në përgjithësi norma e interesit, bashkë me *fee*-të, shkon diku 1,5 % deri në 2,3% në varësi të Euroborit atë ditë, për pjesën tjetër mund të na thotë zëvendësministrja nëse ka ndonjë gjë tjetër.

Belinda Ikonomi – Në lidhje me pjesën e impaktit, më parë isha te Komisioni i Veprimtarive Prodhues edhe dëgjova përfaqësuesit e Bashkisë së Tiranës që thanë se kanë bërë një vlerësim paraprak dhe janë rreth 238 shtëpi, të cilat preken, në njëfarë mënyre, nga zbatimi i këtij projekti. Aktualisht, Bashkia e Tiranës ka marrë të gjitha masat dhe, përveç këtyre që po diskutojmë sot, pra për kredinë dhe grantin, ka edhe një asistencë teknike në shumën prej 600 mijë eurosh pikërisht nga kjo bankë për të vlerësuar sistemin e këtyre familjeve. Sipas të dhënave, rezulton se vetëm 10 % e këtyre shtëpive kanë dokumente pronësie. Ndërsa pjesa tjetër, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e fushës, do të shikohet dhe do të vlerësohet për sistemin e tyre sipas programeve të Bashkisë Tiranës, të cilat janë 3 programe; programet sipas bonove të qirave për një periudhë 3-vjeçare. Bashkia po merr në konsideratë faktin për të ndërtuar banesa sociale në atë zonë, në mënyrë që të bëjë sistemimin e këtyre familjeve që preken në zonë. Më pas, pa dyshim është edhe përfshirja e tyre në programin e tretë, që është sistemimi i tyre nëpër godina sociale ekzistuese nëpër zona të tjera. Në mënyrë të përmbledhur, ky projekt ka konsideruar në mënyrë specifike një nga kushtet bankës për dhënien e kredisë që të mos ketë impakt social dhe nga ana e bashkisë të merren të gjitha masat për sistemimin e...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, e bëtë pazar komisionin. Pini kafe më vonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Së pari, projekti është në vlerë të konsiderueshme, rreth 23 milionë e ca euro dhe do ta zbatojë Bashkia e Tiranës. Dua të kuptoj: ky është një projekt i ri, që do të fillojë të zbatohet pas miratimit të kësaj kontrate, pra nga shkurti i vitit 2021? E kam kuptuar drejt?

Arben Ahmetaj – E ke kuptuar shumë drejt.

Edlira Hyseni – Ky është një projekt i rëndësishëm në vlerë, me sa kuptojmë, dhe do të ketë impakt, sepse do të sjellë patjetër përmirësim, zhvillime e të tjera. Ju thatë që janë 238 banesa, të cilat do të preken, dhe vetëm 10% e tyre janë me dokumente, pra i takon të themi: e thjeshtë procedura e shpronësimit, e dëmshpërblimit. A janë të informuar qytetarët, banorët për të evituar problematikat që dolën tek Astiri i famshëm dhe probleme të tjera? Ju thatë: jo banesa sociale, jo qira e të tjera. A janë ata dakord? A u është marrë një mendim? A janë të informuar; si janë ndjekur procedurat që ky projekt, i cili do të prekë goxha familje, të mos krijojë problematikat dhe zhurmat e mëdha që u bënë për projektet tjera të Tiranës?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zonja Zëvendësministre!

Belinda Ikonimi - Mbase për këtë gjë mund të fliste vetë Bashkia e Tiranës, por përsëri unë po i referohem asaj që konstatova nga pjesëmarrja në komisionin tjetër. Aktualisht, Bashkia e Tiranës ka një asistencë, përpos çfarë diskutohet sot këtu, prej rreth 600 mijë eurosh pikërisht për të bërë ndërgjegjësimin, komunikimet me të gjithë banorët që preken nga ndërtimi i këtij projekti. Pra, është një fond i posaçëm pikërisht për sistemin e situatës nga ana e tyre. Ashtu sikurse u referua edhe nga nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, i cili është ende te Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, kjo është një çështje, për të cilën Bashkia po merr masat paraprakisht për të mos u ndodhur si në rastin e Astirit, pra, për të mos pasur problematika në zbatimin e projektit. Sikundër edhe ju e thatë, projekti parashikohet të përfundojë në shkurt të vitit 2022.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka pyetje tjetër?

Urdhëroni, zoti Roshi! Mirë se erdhe! Faleminderit që gjetët kohën!

Artur Roshi – Mirë se ju gjeta!

Sa i gjatë është segmenti që do të rehabilitohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është! Nuk kishim gjë të shkruar atje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Marrëveshja financiare nuk bëhet në ajër, por bëhet mbi një projekt të caktuar.

A do të preken banesa dhe sa është numri i tyre?

Arben Ahmetaj – U bë kjo pyetje, por nuk prish punë.

Artur Roshi – Cila është mënyra me të cilën do të operoni me banesat që do të preken? Si do të bëhet dëmshpërblimi i tyre?

Arben Ahmetaj – Zonja Zëvendësministre, për pyetjen e dytë, meqenëse keni dhënë përgjigje, fokusohuni edhe një herë shkurt te pjesa si do të veprohet, pra që ju referuat 3 programeve, shpronësimit e të tjera.

Belinda Ikonomi – Faleminderit!

Në lidhje me sistemin e banesave të banorëve që preken, nga ana e Bashkisë së Tiranës, pa dyshim që do të parashikohet për ata, që kanë dokumente pronësie, fondi përkatës për shpronësimin për t'iu dhënë qytetarëve të prekur kontributin, i cili u takon sipas kushteve ligjore. Ndërkohë, për ata qytetarë, që nuk kanë dokumente pronësie, për të cilët nuk është bërë i mundur as procesi i legalizimit, Bashkia e Tiranës ka 3 programe: programi i parë është ofrimi i bonusit të qirave për një periudhë 3-vjeçare; më pas është parashikimi i ndërtesave sociale, pikërisht në atë zonë (ky është një projekt që po ndërmerret nga ana e Bashkisë së Tiranës për të pasur ndërtesa sociale pikërisht për sistemimin e banorëve të prekur); programi i tretë është për sistemimin e banorëve ndoshta edhe në zona të tjera, ku ka ndërtesa për qëllime sociale.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Një pyetje që bëri zoti Roshi ishte: sa është segmenti?

Unë e kuptoj shumë mirë që Ministria e Financave nuk hyn në detajet projektit, sepse nuk është detyrë e autoritetit tuaj dhe nuk është autoriteti përgjegjës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë i nxora përjashta, sepse duhet të respektojnë komisionin. Kjo ishte arsyeja që i nxora përjashta. Ky është komisioni përgjegjës, duhet të vijnë këtu, më pas të shkojnë në komisionet e tjera. Kjo ishte arsyeja. Ai djali i bordit është goxha djalë dhe ka punuar me mua vite e vite, por tani ka procedura...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, do të të kthejë përgjigje tani zëvendësministria. Në qoftë se nuk është përgatitur, edhe mund të mos jetë, do të të dërgojnë një *email* nga ministria. Janë në relacion, gjithsesi, ju keni pasur punë me territorin dhe nuk keni arritur që ta shikoni relacionin dhe mund t'ju vijë nga ministria një informacion.

Urdhëroni!

Belinda Ikonomi – Zoti Kryetar, nuk jam 100% e sigurt, por më duket se është 1,8 kilometra; por nuk jam e sigurt.

Arben Ahmetaj – Një sqarim, dua ta respektojmë zëvendësministren për një arsye shumë specifike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka lidhje për me pasaktësi zëvendësministria. Zëvendësministria është përgjegjëse për zhvillimin ekonomik. Zëvendësministri që merret me.. çështjet financiare

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne e kalojmë, se kemi përgjegjësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është autoritet bashkia. Bashkia është agjenti zbatues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përgjigjuni pak, zonja relatore!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Senida, ju u tërhiqni shpesh vërejtje kolegëve tuaj, tani pse e prishni rregullin?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Evis Kushi – Realizimi i projektit përfshin rreth 1,8 kilometra të lumit Lana dhe përfundon rehabilitimi lumit, i bërë përgjatë, përafërsisht 16 kilometra në rrjedhën e sipërme të zonës së projektit të Bashkisë së Tiranës. Në total zona, që ndikohet nga projekti, shtrihet në një sipërfaqe prej 110 hektarësh, ku janë parashikuar edhe dy ura mbi shtratin e ri të lumit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Zoti Roshi, a keni pyetje tjetër?

Artur Roshi – A mendoni ju se sjell një efekt social?

Arben Ahmetaj – Është bërë kjo pyetje, por nuk ka gjë, përgjigjuni, zonja Zëvendësministre.

Belinda Ikonomi – Pa dyshim projekti, sikurse u përmend, përfshin një zonë të madhe rreth 110 hektarë.

Së pari, do të ketë një impakt shumë pozitiv për zhvillimin e zonës, do të ketë një impakt pozitiv për sistemimin e problematikave, që ka pasur ajo zonë në lidhje me përmytjet. Për sa i përket impaktit social tek ato familje, që mund të preken nga ndërtimi i kësaj rruge, sikurse edhe e referuam më parë, sipas përlogaritjeve të Bashkisë së Tiranës, janë rreth 238 familje, të cilat mund të preken ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, absolutisht u përmend që Bashkia e Tiranës ka një asistencë specifike prej rreth 600 mijë eurosh pikërisht për të mundësuar përballimin e kësaj situate dhe për të dhënë një zgjidhje për sistemin e këtyre njerëzve, në mënyrë që impakti social të jetë pothuajse zero.

Për këtë arsye Bashkia e Tiranës ka programet e saj për zgjidhjen e këtyre situatave dhe, pa dyshim, është në interesin e Bashkisë së Tiranës dhe të gjithë komunitetit që projekti të zbatohet në kohë, por pa krijuar impakte sociale për qytetarët.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po jua them unë: është në relacion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Në relacionin, që shoqëron projektligjin, thuhet: “Nisur nga plani i veprimit dhe implementimit të këtij projekti, vlera e të cilit do të mbulohet nga shpenzimet buxhetore të Bashkisë së Tiranës, do të jetë e shpërndarë në 3 vjetët buxhetorë, duke nisur që nga viti buxhetor aktual”. Ndërsa në një pikë tjetër thuhet: “Ky projekt do të zbatohet nga Bashkia e Tiranës në shkurt të vitit 2022”. Çfarë keni parasysh midis kësaj periudhe, pra nga sot deri në vitin 2022? Çfarë është kjo periudhë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni, nuk është puna e “lalit”. “Lali” do të rrijë edhe 20 vjet, por nuk do të rrijë vetëm kryetar bashkie, do të bëhet përsëri ministër Kulture.

Ju lutem, qetësi!

Pyetja e zonjës Dhima është teknike: si ka mundësi, thotë, që ju e parashikoni për vitin aktual, që do të thotë viti 2020, por e filloni në vitin 2022?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, zonja Zëvendësministre!

Belinda Ikonomi – Po i referohemi relacionit, ku thuhet se vlera mbulohet nga shpenzimet buxhetore të Bashkisë së Tiranës dhe shpërndahet në 3 vjet buxhetorë. Pra, viti 2019, që mund të jenë shpenzimet për fillimin e procesit nga ana e Bashkisë së Tiranës dhe vitet 2020 dhe 2021, ndërkohë projekti parashikohet të mbyllet në shkurt të vitit 2022.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zbatimi, kurse mbyllja bëhet në shkurt të vitit 2022.

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Pse po e kalojmë marrëveshjen financiare tani ne që ta bëjmë në vitin 2022?! Nuk ka kështu...

(Mungesë regjistrimi)

A ka pyetje tjetër? Nuk ka.

Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Roshi!

Artur Roshi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ne shikojmë se qeverisja vendore është e përputhur në instinktet e saj me qeverisjen qendrore dhe kanë krijuar një sistem moral qeverisës, që nuk qëndron në këmbë për shkak të shenjtoreve, por për shkak të mëkateve.

Në lidhje me projektin, shikojmë paqartësi të mëdha, sepse marrëveshja ngrihet mbi një projekt të caktuar. Aty kishte vetëm disa vlera, që mund t'i marrësh në një kafe nga një inxhinier që të jep opinione të momentit. Pra, nuk mund të ngresh një investim, që vlen miliona euro mbi opinione inxhinierike, që mund të jepen në frekuenca kohe 10 minuta apo 15 minuta. Pra, volumet janë ato që përcaktojnë seriozitetin e investimit.

Një gjë tjetër që bie në sy: duke anashkaluar fazën e projektimit, tenderimi i projektimit është anashkaluar dhe e merr po ai që bën zbatimin. Domethënë, sipërmarrësit, zbatuesit, oligarkët apo si të doni ju kanë edhe zyrat e projektimit të gatshme dhe nuk ke nevojë të bësh tender edhe për projektimin, për sipërmarrjen apo për zbatimin. Pra, të gjitha janë të unifikuara në një dorë dhe kemi anashkalimin e transparencës, anashkalimin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, të dëgjoj ty dhe gjithë të tjerët, por kështu është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me informacionin që kemi kështu është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Marrëveshja është tjetër gjë. Ti thua që bashkia kërkoi kaq para dhe ne bëjmë marrëveshjen për kaq para me një kredidhënës. Unë këtë e kuptoj, por ku është rëndësia e Ministrisë së Financave? Ngrihet mbi një projekt!. Si e bën vlerën? *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për shembull, pse kërkove 8 milionë dhe jo 15 milionë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, ti bën një studim mbi një projektide që ka bashkia, për shembull, për të zgjidhur një problem të caktuar infrastrukturor në atë zonë dhe ajo ka një vlerë të caktuar. Si është bërë ky, pa studim? Nuk ka studim. Po, përtej studimit, është projektimi.

Arben Ahmetaj – Zoti Mazniku, do t’ju japë më pas një përgjigje. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në fakt, unë desha të të ngacmoja. Në përgjithësi, se si funksionon ligji shqiptar ju e dini, por në rastin konkret, kur ka donatorë, praktikisht, procesi kalon në disa pika, që nga studimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka rëndësi, donatori e ka paketë, pavarësisht se ne, me rregullat e shtetit shqiptar, duhet t’i kalojmë më vete. Donatori e ka paketë, ku thotë: “Ja paratë e projektimit, ja studimi ambiental, ja studimi social dhe ja projekti i detajuar, i cili ka një fazë të dytë dhe ka një projekt të bërë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk jemi te projektideja.

Artur Roshi – Unë nuk kërkoj projektin e zbatimit, nuk kërkoj projektin e detajuar

Arben Ahmetaj – Po, është. Patjetër që është. Ti bërë pyetjen dhe tani do të flasim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është ashtu!

Arbër Mazniku – I nderuar zoti deputet, për sa i përket pyetjes suaj, ky është një proces që ka nisur para 3 vjetësh. Që në momentin e parë Bashkia e Tiranës pa një situatë në atë zonë, e cila është e turpshme që të jetë në një qytet, aq më pak në Tiranë. Pra, nga segmenti i “Pallatit me shigjeta”, siç njihet deri në pikën ku Lana takohet me “Teodor Kekon”, pra me Unazën e Re, Lana rrjedh në shtrat natyror, pra rrjedh në tokë. Ajo është zona, ku të paktën në 10-12 vjetët e fundit

kemi në mënyrë periodike probleme me përmytjet dhe, të shkosh ta shikosh brenda, është e paimagjinueshme. Ne e kemi filluar punën që para 3 vjetësh, kemi bërë konceptidenë, parametrat zhvillimorë, është bërë detyra e projektimit nga ana e bashkisë, projektzbatimi në nivel përfundimtar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka bërë bashkia vetë; e ka tenderuar, e ka prokuruar dhe ka një kompani që e ka sjell projekt për atë. Më pas me këtë projekt kemi aplikuar te Banka Europiane e Investimeve, ku na kanë thënë se është ndër të paktat herë kur kemi punuar me një autoritet lokal, i cili ka ecur në mënyrë kaq të avancuar me projektin.

Sidoqoftë ata kishin një shqetësim në lidhje me rialokimin e banorëve të zonës, ndaj edhe na dhanë një grant tjetër, i cili nuk është pjesë e marrëveshjes, por është grant drejtpërdrejt për bashkinë, si asistencë teknike, prej 600 mijë eurosh. Ata kanë sjellë ekspertë të tyre, të cilët janë duke bërë dy punë. Kanë 6 muaj që punojnë paralelisht me ne, teksa marrëveshja ishte duke u negociuar me qeverinë dhe po bënte rrugën e vet. Në kemi 6 muaj që po punojmë për dy elemente, për rishikimin e projektit për disa detaje të vogla, veçanërisht për nyejt ndërlidhëse të këtij aksi me lagjet në të dy krahët, në mënyrë që të përmirësohet ndërlidhja. Jemi duke riparë disa elemente të vogla të volumeve të trafikut në nyje, pra që është elementi i dytë teknik është për të parë akset e kthesave, janë refinituara të vogla.

Së treti, është një plan specifik se si do të zgjidhet problemi i banorëve që preken, rast pas rasti. Pra, për secilën prej familjeve që preket do të ketë një zgjidhje personale për ta në një prej programeve të mundshme. Është një punë e bërë deri tani, me shumë detaje dhe, siç tha edhe kryetari, nuk ndodh që BEI, Banka Europiane e Investimeve, të marrë përsipër të futet me grant apo me kredi në një investim, pa u siguruar që ana e projektimit të tij është bërë në detaje dhe sipas standardeve të tyre.

Pra, për fat të mirë, ata e morën projektin (ne kemi çuar të tërë projektin, jo veç koncept-idenë), e panë projektin me ekspertët e tyre në Luksemburg dhe thanë se ky është një projekt sipas standardeve tona dhe nuk ka nevojë të ribëhet.

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Së pari, jam shumë e lumtur si deputete e Tiranës, po ashtu edhe si deputete e një zone ku rehabilitimi i lumit Lana e ka sjellë në normalitet të gjithë zonën. Do të doja që kolegët të mos më ndërhyjnë për sa kohë nuk kanë qenë deputetë të ndonjë zone që lumi Lana

e përmbyste sa herë që binte një pikë shi dhe situata ishte tërësisht kritike për ata banorë. Duhet ta përshëndesim qoftë si projekt, qoftë edhe mbështetjen që ministri i Financave i asaj kohe, po ashtu edhe ministrat sot, që kanë mbështetur realizimin e këtij projekti me pjesën financiare.

Në hyrje kisha falënderimet, sepse realisht ka një ndryshim tërësor në të gjithë zonën, duke kthyer dhe duke rritur edhe vlerën e pronës, sepse, nëse më përpara, kur diskutonim për Bregun e Lumit, ajo ishte zona më fundore dhe më skandalozja që ekzistonte, sot, në kombinim me investimet e tjera të bëra nga Bashkia e Tiranës, po ashtu edhe nga qeveria shqiptare, ajo zonë është kthyer në normalitet dhe nuk kanë asnjë ndryshim nga qendra e Tiranës.

Duke thënë këtë, kam disa meraqe të cilat do të doja, që si deputete e zonës, ku ky projekt do të zhvillohet, pra pjesa e dytë apo e tretë e transhit të projektit, do të doja që, së pari, nga Bashkia e Tiranës të kishte komunikime të vazhdueshme me ato banorë, sepse duke mos pasur shumë informacion mbi projektin, mund të keqpërdoret shqetësimi i tyre për të bërë përsëri politikë, si në Unazë kur kemi protesta të përditshme dhe në krye të protestave janë jo qytetarët që preken, por të ardhurit apo biznesmenët që sot pretendojnë t'i dëmshpërblehen shtëpitë, ndërkohë janë biznese të mirëfillta në zonat që i kanë uzurpuar, por, gjithashtu, i kanë zhvilluar dhe pretendojnë çmime apo mbiuzurpim. Pra, ndryshe nga ajo që mund të ndodhë me banorët, të cilët jetojnë apo që kanë thjesht shtëpi banimi dhe duhet t'u sigurojmë të drejtën për të pasur banesa, nga ana tjetër, kemi ata që tentojnë për të bërë politikë me projekte madhore.

Në këtë aspekt, meqenëse kemi pasur shqetësime për këtë projekt prej muajsh, unë do të kisha pritur që nga Bashkia e Tiranës të kishte pasur takime me banorët që preken nga ky projekt, të cilët nuk janë pak, por janë më shumë se 230 shtëpi (shtëpi të mirëfillta dhe jo biznese). Duhet të shpjegohet se çfarë efekti ka projekti, sa i prekë ata. Në qoftë se arrijmë të specifikimi, në pjesën e zbatimit, a mund të shpëtojë një pjesë e banesave, sepse ne jemi të bindur se, nëse një banesë, sipas të gjitha çmimeve të tregut mund të dëmshpërblehet me tot-lekë, ato tot- para nuk vlejnë për të blerë po të njëjtën shtëpi diku tjetër. Kështu që, në këtë pjesë unë mendoj se duhet ta shikojmë të pjesa e projektzbatimit, çfarë mund të shpëtohet, pa cenuar atë që është objektivi dhe qëllimi kryesor (prandaj thashë të shikojmë, sepse ka pasur shumë abuzime me lajmet mbi këtë projekt). Nga ana tjetër, mendoj se, pasi të kalojmë pjesën e marrëveshjes, së bashku me Bashkinë e Tiranës të shikojmë në zonë dhe t'ua shpjegojmë qytetarëve se çfarë ndodh, si ndodh dhe ku do të arrihet, që të mos përfundojmë të kemi përsëri një Astir të dytë, që nga abuzimi tejkalon dhe bllokun jetën e gjithë qytetit të Tiranës.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Vërejtje me vend. Besoj se nënkryetari i bashkisë e mbajti shënim. Jemi duke folur për një aks shumë të rëndësishëm infrastrukturor.

Nuk ka qëndrim tjetër. Kalojmë te votimi në parim.

Kush është pro? Kundër? 3 vota. Abstenim?

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Të më sillet raporti i përkthyer!

Faleminderit!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 01.10.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban””.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Krenar Ryçi, Evis Kushi, Arben Elezi, Korab Lita, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Anastas Angjeli dhe Ervin Bushati.

Të ftuar:

Belinda Ikonimi – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi - Drejtore në Ministrinë e Financave Ekonomisë
Ekonomisë

Arbër Mazniku – përfaqësues i Bashkisë së Tiranës

Arben Ahmetaj – Kalojmë te pika 3.

Relator është zoti Xhevit Bushaj.

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”.

Urdhëroni!

Xhevit Bushaj - Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar të ftuar nga Ministria e Financave dhe të Bashkisë së Tiranës,

Në cilësinë e komisionit përgjegjës ne sot shqyrtojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”.

Shqyrtimi i këtij projektligji bëhet ne zbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit, sipas përcaktimeve të neneve 7883, pika 1 dhe nenit 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Marrëveshja e grantit është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.403, datë 19.6.2019 dhe është nënshkruar ndërmjet palëve.

Vlera e grantit e akorduar nga Banka Europiane e Investimeve sipas kësaj marrëveshjeje është në shumën 2,4 milionë euro.

Kjo shumë do të shërbejë për bashkëfinancimin e projektit “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”, për të cilin Banka Europiane e Investimeve ka akorduar edhe një kredi në shumën 8 milionë euro, ndërsa pjesa tjetër e financimit do të përballohet nga fondet e buxhetit të bashkisë në shumën 13.37 milionë euro. Kostoja totale e projektit, siç vlerësohet nga Banka Europiane e Investimeve, është 23770 mijë euro.

Granti objekt i kësaj marrëveshjeje, së bashku me bashkëfinancimet, ka për qëllim mundësimin e realizimit të projektit “Shtrati i lumit Lana - Projekti i Zhvillimit Urban” projekt ky që përfshin vepra rreth 1.8 km të lumit Lana dhe përfundon rehabilitimin e lumit të bërë përgjatë përafërsisht 16 km në rrjedhën e sipërme të zonës së Projektit në Bashkinë e Tiranës. Zona që ndikohet nga projekti shtrihet në një sipërfaqe prej 110 ha dhe në të janë parashikuar 2 ura mbi shtratin e ri të lumit për nevojat e zhvillimit urban.

Projekti përfshin zgjerimin e dy bulevardeve, të cilat janë paralele me lumin Lana, përkatësisht bulevardet, "Gjergj Fishta" dhe "Bajram Curri", deri te kryqëzimi me rrugën "Teodor Keko" dhe ka për qëllim zgjatimin e bulevardit nga Ura Teknologjike (ku përfundon aktualisht segmenti ekzistues) deri në kryqëzimin me rrugën "Teodor Keko" dhe rehabilitimin e shtratit të lumit të Lanës po për këtë segment.

Nëpërmjet këtij projekti mundësohet krijimi i një shtrati me regjim hidrik eficient, për të eliminuar problematikën e përmbytjeve në këtë zonë, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme të zhvillimit urban të zonës. Autoriteti Kombëtar i Ujit (AKUK) po udhëheq ndërtimin e impiantit të parë të trajtimit të ujit në rrethin e Kasharit, që pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2022.

Projekti do të ndërtohet gjatë periudhës 2019-2022.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Lidhur me vlerën e grandit të akorduar sipas kësaj marrëveshjeje nuk parashikohen shpenzime nga Buxheti i Shtetit.

Për sa i takon efekteve financiare, vlera që do të mbulohet nga fondet e buxhetit të Bashkisë Tiranë në vlerën 13.37 milionë lekë, do të jetë të shpërndara në 3 vite buxhetore, duke nisur që nga viti buxhetor aktual.

Së fundi, duke vlerësuar se ky projekt do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e zonave përkatëse, duke siguruar një infrastrukturë të qëndrueshme, e cila do t'i shërbejë edhe zonave përreth saj dhe duke përmirësuar gjendjen tejet të amortizuar të infrastrukturës ekzistuese, e ftoj komisionin që ta miratojmë atë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Kam një koment për Ministrinë e Financave. Nuk po e rrëzoj grantin (po të ishte ministri ose zëvendësministri tjetër, do ta kisha rrëzuar) për arsye se nuk mund të jetë relacioni mot-a-mot me marrëveshjen dhe me këtë. Është turp.

(Ndërprerje incizimi)

Nuk keni gjë për të shtuar nga ajo që tha Xheviti.

Faleminderit!

A ka ndonjë pyetje?

Faleminderit!

Kalojmë në votim.

Votojmë në parim marrëveshjen e grantit.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Të më vijnë raportet për firmë që të dërgohen direkt në seancë.

Faleminderit!

Faleminderit deputetëve!

Faleminderit, zonj Belinda!

Faleminderit, ralatorëve!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti